

**NJOFTIM PUNE**

**Profili i kompanisë:** **Balkan Finance Investment Group** është një ndër grupet private investuese më të mëdha në Shqipëri dhe rajon, i pranishëm me aktivitete për zhvillimin e pasurive të paluajtshme, shitjet me pakicë, ofrimin e shërbimeve dhe manaxhimin e hapësirave tregtare apo industriale, telekomunikacion, industria minerare, financime dhe programe besimi për konsumatorët.

SPAR Albania është pjesë e Balfin Group dhe drejton rrjetin më të madh të shitjeve ushqimore me pakicë me të drejtën e ekskluzivitetit të emrit “SPAR”.

**Pozicioni:** Menaxher Kategorie (Fresh)

**Departamenti:** i Blerjeve

**Vendodhja:** Tiranë

**Përmbledhja e Pozicionit:** Të kryejë, të gjejë dhe aplikojë strategji për kategorinë përkatëse ku është përgjegjës; Të arrijë dhe të përfitojë kosto optimale nëpërmjet negociatave efektive me furnitorë të ndryshëm si dhe të identifikojë mënyrën më të mirë për kostot më efikase; Ky pozicion kërkon nga personi që të sigurojë se kompania do të ketë produktin e duhur, në kohën e duhur, me qëllim që të ketë shitje dhe rritje të të ardhurave.

**Detyra dhe Përgjegjësi:**

- Të kryejë analizën e tregut dhe konkurrencës për produktet e kategorisë;
- Të përzgjedhë dhe të aplikojë strategji për kategorinë përkatëse bazuar në strategjinë e kompanisë;
- Gama e produkteve – studimi i linjës së plotë të një produkti, të jetë njohës i mirë i produktit;
- Të kërkojë për produkte të reja të cilat do të ndihmojnë në rritjen e të ardhurave të kompanisë;
- Kontrolli mbi çmimet – të negociojë koston optimale të produkteve me furnitorët dhe të arrijë në përfundimin që Kompania të ketë çmimet më të lira në treg;
- Të përgatisë dhe planifikojë – implementimin e produkteve në raftë;
- Aktivitetet promovionale – të bashkëpunojë me furnitorët për planin e aktiviteteve promovionale;
- Të zbatojë planin në bashkëpunim me Departamentin e Marketingut dhe Operacionalin;
- Buxheti – të përgatisë planin biznesin për kategoritë e veta përkatëse;
- Të përzgjedhë dhe listojë furnitorët;
- Është përgjegjës për shitjet dhe përfitimet për kategorinë të cilin ai mbulon;
- Të negociojë për kushtet më të mira për Kompaninë bazuar në kriteret e kontratës me Kompaninë;
- Të përcaktojë objektivat e performancës për furnitorët;
- Të bëjë përmbledhje për të gjitha kushtet e kontratës dhe t’ua japë departamenteve që

kanë lidhje me to, si Financës (periudhën e pagesës, bonuse për furnitorët), Logjistikës për kohën e dorëzimit, Marketingut për promocione;

- Të krijojë një raport pozitiv dhe të qëndrueshëm me të gjithë furnitorët dhe të jetë kontakti kyç për Kompaninë dhe shitjet;
- Të punojë me shitjet për të siguruar disponueshmërinë e produkteve, dorëzimin si dhe të zgjidhë çmimet apo çdo problem tjetër.
- Të bashkëpunojë me Operacionalin dhe Menaxherët e Dyqaneve për të përditësuar markat dhe nevojat e dyqaneve kur ato duhet të marrin vendime;
- Të përgatisë dhe analizojë raporte për kategorinë që ka në ngarkim;
- Është përgjegjës për të gjithë dokumentacionin dhe të dhënat që i përkasin kategorisë që ai mbulon;
- Duhet të bashkëpunojë me departamentet e tjera si Marketingun, Financën, Burimet Njerëzore, Logjistikën, Shitjet, IT, dhe Ekspansionin për zgjidhje të problemeve të ndryshme;
- Të njohë dhe të përdorë shumë mirë sistemin operues, etj.

**Kërkesat:**

**Edukimi:** Të zotërojë diplomë universitare, preferohet në Administrim Biznesi dhe/ose Marketing.

**Eksperiencat e punës:** Të ketë përvojë pune në pozicione të ngjashme minimumi 2 vite.

- Përparësi kanë kandidatët që kanë njohuri dhe eksperiencë me produktet e kësaj kategorie.

**Kualifikime të tjera:**

- Aftësi kompjuterike të paketës Microsoft Office;
- Njohuri të mira të gjuhës Italiane dhe asaj Angleze.

**Aftësi të tjera:**

- Të jetë person i motivuar dhe ambicioz;
- Të ketë sensin e tregtisë dhe të jetë i orientuar;
- Të ketë aftësi të larta negociimi;
- Të jetë i aftë që të punojë nën presion;
- Të dijë të marrë vendime dhe të jetë i përgjegjshëm.

**Kushtet e punës:** Ofrohet pagë konkurruese.

**Mënyra e aplikimit\*:** Kandidatët e interesuar janë të lutur të dërgojnë CV e tyre së bashku me letër motivimi në adresën e e-mailit [hr@spar.al](mailto:hr@spar.al) duke përcaktuar në subjekt pozicionin, online nëpërmjet faqes së Web-it Spar.al, ose nëpërmjet postës në adresën: SPAR Tirana East Gate (TEG), Rruga Nationale Tiranë-Elbasan, Farkë (Lundër), Tiranë, Shqipëri.

**Afati i dorëzimit:** 24/01/2020

*\*Të gjitha aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet të plotë sipas ligjit Nr .9887 vendosur nga Kuvendi i Shqipërisë për "Mbrotjtjen e të Dhënave Personale".*